



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

Datë ____ .11.2022

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastër, përmes procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele si më poshtë:

1. Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastër

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë :

- a) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokurorët e komanduar;
- c) prokurorët në skemë delegimi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë i’u bën thirrje që të kandidojnë të gjithë prokurorëve që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;
- ç) të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40, pika 2, germa “b” e ligjit për statusin.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se data **05.12.2022**.

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa për shprehjen e interesit ku renditen deri në tre pozicione sipas radhës së preferencës, për të kandiduar për pozicionin/et e lira të shpallur;
- b) Një jetëshkrim i përditësuar;
- c) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- ç) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin;
- d) Çdo dokument tjetër që e gjykon të arsyeshëm kandidati.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentat e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.